



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 577 Akti

Nr. 696 Vendim  
Tiranë, më 11.9.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesues
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Ferdinando Buatier de Mongeot, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 10.5.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Marsida Frashëri**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi analizoi të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ së bashku me provat shkresore, si dhe pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj saj,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Marsida Frashëri, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Valbona Sanxhaktari. Kryesues i trupit gjykues u zgjodh komisioner Lulzim Hamitaj. Si relatore e

çështjes u zgjodh me short komisionere Valbona Sanxhaktari, ndërsa vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi u caktua z. Ferdinando Buatier de Mongeot, i cili mori pjesë në mbledhjet e trupit gjykues gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore.

**3.** Në datën 3.7.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua për përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e tij.

**4.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me fillimin e hetimit administrativ janë administruar nga relatori raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

**5.** Subjekti i rivlerësimit është kontaktuar nëpërmjet adresës elektronike, të deklaruar prej saj, në të cilën iu dërgua pyetësori standard i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera gjatë hetimit administrativ. Nga komunikimet elektronike ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur komunikimeve të Komisionit dhe ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit.

**6.** Relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

**7.** Në datën 4.4.2022, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, diskutoi mbi rezultatet e hetimit provat e mbledhura dhe, në vijim, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri. Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**8.** Në datën 4.4.2022, Komisioni njoftoi nëpërmjet postës elektronike subjektin e rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, për përfundimin e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës, si dhe iu bënë me dije të drejtat në bazë të ligjit për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, brenda datës 19.4.2022.

**9.** Subjekti i rivlerësimit, në datat 14.4.2022 dhe 21.4.2022, ka kërkuar dy herë shtyrjen e afatit për dorëzimin e shpjegimeve për rezultatin e hetimit me arsyetimin se ishte në pamundësi objektive për të siguruar brenda afatit të caktuar nga Komisioni dokumentacionin e gjykuar prej saj, si të domosdoshëm për të realizuar një mbrojtje efektive. Komisioni ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit, duke e shtyrë afatin për dorëzim dokumentacioni deri në datën 4.5.2022.

**10.** Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prapësimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në rrugë elektronike në datën 3.5.2022, të administruara edhe në rrugë shkresore pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2022, të cilat u pranuan dhe u morën në shqyrtim prej tij.

**11.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në datën 10.5.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit ishte prezente personalisht dhe paraqiti dokumentacion shtesë, i cili është administruar në dosjen e subjektit të rivlerësimit.

**12.** Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 10.5.2022, trupi gjykues u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 58, nenit 44/b, si dhe të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendim të ndërmjetëm vendosi:

“Pezullimin nga detyra të znj. Marsida Frashëri, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”.

**13.** Vendimi i ndërmjetëm i Komisionit iu njoftua subjektit të rivlerësimit në seancën publike të datës 13.5.2022, në të cilën ajo ishte prezent e që u zhvillua në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, nën prezencën e vëzhguesit ndërkombëtar gjithashtu.

**14.** Vendimi i ndërmjetëm nr. 577 akti, datë 13.5.2022, i Komisionit “Për pezullimin nga detyra të znj. Marsida Frashëri dhe detyrimin e saj për të ndjekur programin njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës”, iu njoftua palëve dhe u publikua në datën 13.6.2022.

**15.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.6.2022, vendimi i ndërmjetëm i Komisionit nr. 577 akti, datë 13.5.2022, “Për pezullimin nga detyra të znj. Marsida Frashëri dhe detyrimin e saj për të ndjekur programin njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës”, iu dërgua Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përgatitjen e programit të trajnimit për subjektin e rivlerësimit.

**16.** Në vijim, Komisioni është njoftuar nga Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2023, në mbarim të programit të trajnimit të znj. Marsida Frashëri, për rezultatet e provimit përfundimtar, nga ku rezultoi përfundimi me sukses i tij.

**17.** Pas administrimit të këtij informacioni, trupi gjykues u mbledh në dhomë këshillimi në datën 8.9.2023, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, ku diskutoi, vlerësoi dhe vendosi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues të kërkuar nga neni 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, se gjithashtu ajo ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe atë të figurës e, në vijim, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, për të tria kriteret e vlerësimit.

**18.** Komisioni ftoi subjektin e rivlerësimit në seancë publike në datën 11.9.2023, si dhe e njoftoi atë publikisht.

**19.** Seanca e shpalljes së vendimit u zhvillua në Pallatin e Koncerteve në datën 11.9.2023, ora 13:50, me pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

## **II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**20.** Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë në tërësi, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* lidhur me rrethanat e çështjes.

**21.** Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pabazuar në përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse<sup>1</sup>.

**22.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016;

b) raportin e dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqëruar, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016;

<sup>1</sup> Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese (cit): “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi”.

- c) informacionin e përditësuar nga institucionet ligjzbatuese sipas përcaktimeve ligjore;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga KLP-ja, së bashku me materialin shoqëruar, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 84/2016;
- d) dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit shkresor, elektronik dhe gjatë seancës dëgjimore;
- e) denoncimet nga publiku, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

**23. ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2019, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstaton se për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri:**

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e saj;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**24. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon:**

**25. Gjendje *cash* nga kursimet e pagës si prokurore në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë.** Burimi i krijimit sipas Deklaratës *Vetting* janë kursimet e pagës si prokurore:

- a) në DPV-në para fillimit të detyrës së vitit 2009, si dhe në DPV-të e viteve 2009 – 2014 subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*;
- b) në DPV-në e vitit 2015 subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në shumën 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) lekë;
- c) në DPV-në e vitit 2016 subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë.

**25.1** E pyetur lidhur me mënyrën e deklarimit të gjendjes *cash*, subjekti i rivlerësimit shpjegon: *“Të gjitha kursimet e mia të deklaruara burojnë vetëm nga të ardhurat e pagës. Më lejoni të shpjegoj se lidhur me gjendjen *cash*, për të gjitha vitet e deklarimit, unë kam deklaruar gjendjen momentale të ndryshuar, që do të thotë se shuma e kursyer përgjatë vitit 2016 ka qenë diferenca ndërmjet vlerës së deklaruar *cash* 200.000 (dyqind mijë) lekë me vlerën e deklaruar *cash* një vit më parë në vlerën 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) lekë. Në rastin konkret, kjo diferencë është 115.000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë. Këtë sqarim e kam parashtruar edhe para Inspektorit të ILDKPKI-së, për kontrollin e ushtruar në periudhën katërvjeçare 2017 – 2020”.*

**25.2** Komisioni përgatiti analizën financiare mbi mundësinë e subjektit për të krijuar gjendjen *cash* sipas deklaratimeve, nga e cila rezultoi se ka mundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e kësaj gjendjeje.

**25.3** Në përfundim, rezultoi se subjekti ka deklaruar gjendje dhe jo shtesa apo pakësime. Ajo ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e tyre. Komisioni nuk ka konstatuar problematika të tjera lidhur me këtë pasuri.

**26. Subjekti i rivlerësimit deklaroi si vendqëndrim adresën:** lagjja “\*\*\*”, Rruga \*\*\*, Tiranë.

**26.1** Subjekti i rivlerësimit, në DPV-të ndër vite, deklaroi:

- a) në DPV-të e viteve 2012 – 2013 deklaroi si adresë banimi rrugën “\*\*\*”, Tiranë;

b) në DPV-në e vitit 2016 deklaroi si adresë banimi lagjja “\*\*\*\*”, Rruga \*\*\*, Tiranë.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**26.2** Duke qenë se subjekti ka ushtruar funksionin e saj si prokurore në qytetin e Shkodrës, Komisioni e ka pyetur atë për mënyrën e realizimit të marrëdhënieve të punës dhe nëse ka pasur një adresë banimi në këtë qytet.

**26.3** Subjekti i rivlerësimit sqaron<sup>2</sup> për Komisionin se: *“Nuk kam pasur asnjëherë adresë banimi dhe qëndrimi në qytetin e Shkodrës. Nuk e kam një të tillë as aktualisht. Marrëdhënia e punës është realizuar duke udhëtuar vajtje-ardhje Tiranë-Shkodër, për 10 (dhjetë) vjet, me mjete të transportit publik e, në raste sporadike, me kolegë që vinin në qendrën e punës me mjetet që përdornin. Gjatë kësaj periudhe kam qëndruar në Tiranë ditëve të javës dhe pa përjashtuar ditët në fundjavë, për shkak të pamundësisë për ta realizuar marrëdhënien e punës duke qëndruar në adresën e vendbanimit tim, Elbasan”.*

**26.4** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard<sup>3</sup>, sqaron se *në periudhën 2009 – 2015 ka banuar në Tiranë në një apartament 1+1, pallat ekzistues, rruga “\*\*\*\*”. Banesa ka qenë në pronësi të shtetasit G. D.. Çmimi i qirasë ishte 20.000 (njëzet mijë) lekë, të cilin ia ka paguar cash, dorazi, çdo muaj, pronarit të banesës ose sipas rastit bashkëshortes së tij. Në vijim, deri në muajin korrik 2020, në Tiranë, ka banuar në apartamentin/garsionere 1+1, me sipërfaqe rreth 56 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, ndërtesa/pallati \*\*\*, hyrja \*\*\*, Rruga \*\*\*, Njësia Administrative Nr. \*\*\*, \*\*\*, kompleksi “\*\*\*\*”. Apartamenti i përkiste shtetases R. M.. Çmimi i qirasë ishte 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, të cilin ia ka paguar cash, dorazi, çdo muaj, pronares së banesës ose familjarit të saj. Në muajin tetor 2019 ka formalizuar kontratën e qirasë, të cilën e ka bashkëngjitur me dokumentacionin”.*

**26.5** Komisioni ka hetuar për konfliktin e interesit në lidhje me shtetasen R. M., duke kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër informacion nëse subjekti ka hetuar, mosfilluar apo pushuar procedime me këtë shtetase, nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna<sup>4</sup>.

**26.6** E pyetur se si ka mbuluar shpenzimet e jetesës dhe të qirasë (me vendbanim të përhershëm në Elbasan, punësim në Shkodër dhe vendqëndrim në Tiranë), subjekti i rivlerësimit deklaroi në pyetësor standard se këto shpenzime janë përballuar nga të ardhurat nga paga si prokurore, duke deklaruar se i ka shpenzuar plotësisht ato. Këto shpenzime të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit janë përfshirë në analizën financiare.

**26.7** Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka banuar në qytetin e Tiranës prej vitit 2009, periudhë që përkon me emërimin e saj për kryerjen e stazhit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2010 – 2018, ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, por ka vijuar të banojë në Tiranë.

**26.8** Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit nëse gjatë ushtrimit të funksionit të saj ka hetuar çështje me shtetasin G. D., i cili ushtron profesionin e avokatit.

**26.9** Në përgjigje të pyetësorit të datës 11.10.2021, subjekti sqaron për Komisionin se: *“Nuk kam pasur asnjëherë çështje me z. D. dhe kjo për dy arsye kumulative:*

*a) përkushtimit tim të qëndrueshëm për të ruajtur në çdo kohë vlerat që duhet të ketë magjistrati;*

*b) personalitetit korrekt, të matur dhe me integritet të shfaqur nga z. D. dhe, po kështu, bashkëshortja e tij. Marrëdhënia e qirasë është shkaku i vetëm i komunikimeve tona ndërpersonale, të cilat nuk kanë qenë ndonjëherë të karakterit profesional, as në nivel teorik. Marrëdhënia e qirasë me z. D. ka nisur për shkak të besimit minimal të nevojshëm të krijuar*

<sup>2</sup> Shihni përgjigjen nr. 1 në pyetësorin e datës 11.10.2021.

<sup>3</sup> Shihni përgjigjen nr. 1 në pyetësorin standard.

<sup>4</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2022.

*mbi bazën e ekzistencës së një marrëdhënieje miqësore të hershme dhe të konsoliduar ndërmjet tij dhe bashkëshortit të ndjerë (ka ndërruar jetë në korrik 2009) të tezes sime, i cili ka qenë jurist dhe ka ushtruar edhe profesionin e avokatit. Në dijeninë time, z. D. ka ushtruar profesionin e tij në fushën e së drejtës civile dhe nuk ka pasur ndonjëherë çështje me karakter penal në Prokurorinë Shkodër”.*

**26.10** Komisioni i ka kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nëse subjekti ka hetuar, mosfilluar apo pushuar procedime me shtetasin G. D., nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna<sup>5</sup>.

**26.11** Në përfundim, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka gjendjen civile dhe adresën e përhershme të banimit në Elbasan, jeton në Tiranë dhe punon në Shkodër. Lidhur me shpenzimet, ato janë përfshirë në analizën financiare sipas deklarimeve të subjektit, ndërsa lidhur me pasuritë e marra me qira nga subjekti nuk kanë rezultuar problematika apo *indicie* për hetime të mëtejshme nga Komisioni.

## **DEKLARIMET E PERSONAVE TË LIDHUR ME SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT**

**27.** Personi i lidhur B. F., babai i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar pronësinë mbi një apartament banimi me sipërfaqe 55m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, shkalla \*\*\*, apartamenti \*\*\*, i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 26.12.1995, si pasuri nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në ZVRPP-në Elbasan; pasuri e përfituar nëpërmjet privatizimit.

**27.1** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009 dhe në vijim si adresë banimi në gjendjen civile vendndodhjen e kësaj pasurie.

**27.2** ASHK Elbasan ka konfirmuar<sup>6</sup> pronësinë e kësaj pasurie në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit, shtetasve B. dhe E. F., duke përcjellë edhe kartelën e pasurisë së paluajtshme, sipas së cilës kjo pasuri figuron e regjistruar në datën 10.2.2001 dhe vlera e paguar është 2.200 (dy mijë e dyqind) lekë.

**27.3** Komisioni e verifikoi nëpërmjet sistemit *online* të ASHK-së këtë pasuri, për të cilën në përfundim nuk ka konstatuar problematika, si dhe nuk kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme.

**28. Personi i lidhur B. F.**, babai i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar kursime *cash* nga pensioni i pleqërisë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

**28.1** ISSH-ja konfirmon<sup>7</sup> se shtetasi B. F. ka përfituar pension si trajtim i veçantë i punonjësve të industrisë ushtarake për periudhën prill 2004 – qershor 2015, në vlerën 17.337 (shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e shtatë) lekë/muaj dhe ka përfituar pension pleqërie për periudhën nga korriku 2015 e në vijim në vlerën 20.970 (njëzet mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë.

**28.2** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar vërtetim nga ISSH<sup>8</sup>-ja lidhur me të ardhurat e përfituara nga babai i saj për çdo vit, nga i cili rezulton se ai ka përfituar pension si trajtim i veçantë i punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, për periudhën 1.1.2009 – 4.7.2015, të ardhura totale në vlerën 1.094.974 (një milion e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë dhe ka përfituar të ardhura nga pensioni i pleqërisë për periudhën 4.7.2015 – 31.12.2016, në shumën 368.036 (treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tridhjetë e gjashtë) lekë.

**28.3** Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësitë e krijimit të shumës 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë nga personi i lidhur/babai i subjektit, nga e cila ka rezultuar se ai ka mundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e kësaj gjendjeje *cash* të deklaruar.

<sup>5</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2022.

<sup>6</sup> Referojuni shkresës datë 25.10.2019 të ASHK-së Elbasan.

<sup>7</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, seksioni \*\*\*.

<sup>8</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, seksioni \*\*\*.

**28.4** Nuk janë konstatuar problematika në lidhje me kursimet *cash* të deklaruara nga personi i lidhur apo të dhëna për hetime të mëtejshme.

**29. Personi i lidhur E. F.**, nëna e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar kursime në gjendje *cash* në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë me burim nga të ardhurat e pensionit të pleqërisë të përfituar datë 2.1.2014.

**29.1** Në Deklaratën *Vetting*, nëna e subjektit të rivlerësimit deklaroi të ardhura nga puna dhe shpërblimet si punonjëse pranë spitalit psikiatrik në Elbasan me profesion kryeinfermiere për periudhën 1.10.2009 – 31.12.2013, në shumën totale 1.987.276 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, si dhe të ardhura nga përfitimi i pensionit të pleqërisë dhe shpërblime në fundvit për periudhën 2.1.2014 – 31.12.2016, në shumën totale 907.697 (nëntëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

**29.2** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar vërtetim nga spitali psikiatrik Elbasan lidhur me të ardhurat neto të përfituara për periudhën tetor 2009 – dhjetor 2013 në shumën totale 1.987.276 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë dhe vërtetim nga ISSH<sup>9</sup>-ja lidhur me të ardhurat e përfituara nga pensioni i pleqërisë për periudhën janar 2014 – 31.12.2016, në shumën 889.697 (tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

**29.3** Nga hetimi i lëvizjeve të llogarisë së nënës së subjektit ka rezultuar se në BKT ka kaluar çdo muaj paga neto në llogarinë rrjedhëse në lekë të saj për periudhën 2009 – 2013.

**29.4** ISSH-ja ka konfirmuar bazuar në shkresën e ILDKPKI-së<sup>10</sup> se shtetasja E. F. ka qenë e punësuar pranë \*\*\* Elbasan dhe për periudhën kontributive janar 2012 – dhjetor 2013<sup>11</sup> ka përfituar pagën neto në shumën totale prej 931.130 (nëntëqind e tridhjetë e njëmijë e njëqind e tridhjetë) lekësh dhe nga janari 2014 e në vijim ka përfituar pension pleqërie në masën 25.795 (njëzet e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë/muaj.

**29.5** Komisioni përgatiti analizën financiare, nga ku ajo rezultoi me balancë pozitive.

**29.6** Nuk janë konstatuar problematika lidhur me pasurinë e deklaruar nga personi i lidhur, si dhe nuk kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme.

**30. Personi i lidhur A. F.**, motra e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar kursime nga paga në llogari bankare në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë. Burimi i krijimit: kursime nga paga si punonjëse e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., dega Elbasan, në llogarinë bankare në BKT.

**30.1** Nga hetimi i llogarive bankare në BKT rezultoi se shtetësia A. F. ka depozituar *cash* shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë në datën 13.1.2017, në llogarinë e saj të pagës dhe ka çelur depozitë bankare me afat 6-mujor në këtë shumë. Kjo depozitë është rinovuar vazhdimisht dhe aktualisht vazhdon të jetë depozitë bankare me afat.

**30.2** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në ILDKPKI<sup>12</sup> si dokumentacion vërtetimin nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., i cili vërteton se shtetasja A. F. është punonjëse në shoqërinë e sigurimeve “\*\*\*\*” sh.a., dega Elbasan. Sipas vërtetimit dhe listëpagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat personale, shtetasja A. F. ka përfituar pagën neto në shumën 1.030.921 (një milion e tridhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekë, si dhe bonuse në vlerën 412.300 (katërqind e dymbëdhjetë mijë e treqind) lekë për periudhën shtator 2013 – 2016.

**30.3** ISSH-ja ka konfirmuar<sup>13</sup> se shtetasja A. F. është e punësuar pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. dhe për periudhën shtator 2013 – dhjetor 2016 ka përfituar pagë neto në shumën totale 880.420 (tetëqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e njëzet) lekë.

<sup>9</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, seksioni \*\*\*.

<sup>10</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, seksioni \*\*\*.

<sup>11</sup> Në shkresën e ISSH-së citohet se të dhënat janë nxjerrë nga sistemi informatik i këtij institucioni dhe disponohen nga viti 2012 e në vazhdim.

<sup>12</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, seksioni \*\*\*.

<sup>13</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, seksioni \*\*\*.

**30.4** Nga verifikimi i llogarive bankare ka rezultuar se shtetasja A. F. ka llogari page në monedhën lekë, në BKT, dhe për periudhën shtator 2013 – dhjetor 2016 ka përfituar shumën totale 1.494.208 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetë) lekë, e kredituar çdo muaj në llogarinë e pagës, e përbërë nga shuma 1.143.000 (një milion e njëqind e dyzet e tre mijë) lekë si pagë mujore dhe shuma 350.800 (treqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind) lekë, e cila përfaqëson bonusin e përfituar nëpërmjet bankës për periudhën 2015 – 2016, e cila rezultoi se është përfituar në vlerën bruto, duke marrë në konsideratë shumat e bonusit sipas vërtetimit të sjellë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a.

**30.5** Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësitë e krijimit të shumës 200.000 (dyqind mijë) lekë nga motra e subjektit, duke marrë në konsideratë në mënyrë potenciale të ardhurat nga paga për të cilat janë paguar kontributet dhe detyrimet tatimore e shpenzimet përkatëse jetike, si dhe duke kryer një analizë kumulative për të gjithë periudhën (në mungesë të deklaramëve), nga e cila rezultoi se motra e subjektit të rivlerësimit ka mundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

**30.6** Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me pasurinë e deklaruar nga personi i lidhur, si dhe nuk kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme.

**31. Personi i lidhur E. F.**, vëllai i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar depozitë në BKT, në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë. Burimi i krijimit: kursime nga paga ndër vite si punonjës i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.

**31.1** Nga hetimi i llogarive bankare rezulton se kjo depozitë është krijuar nga shtetasi E. F. në datën 24.1.2017, në BKT, dega Elbasan, dhe shuma është derdhur *cash* prej tij. Kjo depozitë është rinovuar vazhdimisht dhe aktualisht vazhdon të jetë depozitë bankare në vlerën 3.040.968 (tre milionë dyzet mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, me afat maturimi 25.1.2021 në këtë bankë.

**31.2** Subjekti konfirmon<sup>14</sup> për Komisionin se: *“Sasia prej 3.000.000 (tre milionë) lekësh ka si burim të vetëm të ardhurat e akumuluar të vëllait nga shpërblimi i punës së tij nga marrëdhënia e punësimit në shoqërinë tregtare “\*\*\*\*” sh.a., që daton fillesat para më shumë se 20 vitesh, në datën 3.7.1999. Të ardhurat janë plotësisht të verifikueshme dhe të ligjshme, për të cilat janë shlyer detyrimet tatimore sipas ligjit, nga punëdhënësi i tij i vetëm për më shumë se 20 vjet, “\*\*\*\*” sh.a.”.*

**31.3** Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë në lidhje me derdhjen në llogarinë e tij të shumës 3.000.000 (tre milionë) lekë, në BKT, në datën 24.1.2017, për mënyrën si e ka mbajtur ai këtë shumë deri në datën e derdhjes *cash* dhe për arsyen pse ka vendosur ta derdhë pikërisht në datën 24.1.2017 (megjithëse deklaroi se janë kursime ndër vite nga paga).

**31.4** Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar<sup>15</sup> për Komisionin se: *“Shumën 300.000 (treqind mijë) lekë vëllai e ka mbajtur në gjendje cash dhe kjo llogari (depozitë) është hapur në BKT me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë në konditat e një personi madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të disponuar lirisht pasurinë e tij. Nga komunikimi me të më rezultoi se banka në fjalë është përzgjedhur prej tij arsyeshëm në logjikën e sistemit të rregulluar kapitalist, si banka që gëzon besimin dhe ofron garancitë më të mëdha në sistemin financiar-bankar që operon në Shqipëri. Shuma në fjalë përbën kursime që rrjedhin nga një punë rreth 18-vjeçare deri në momentin e deklaramit, marrëdhënie punësimi e vazhdueshme, e qëndrueshme dhe e pandryshueshme, tek i njëjti punëdhënësi. Në periudhën që u miratua ligji nr. 84/2016 dhe nisi zbatimin e tij, me qëllim transparencën e plotë ndaj këtij procesi, pas komunikimit me familjarët e mi për këtë çështje duke qenë se edhe ata morën cilësinë e subjektit të këtij ligji, u vura në dijeni për këtë gjendje cash të disponuar prej vëllait dhe që ishte menduar prej tij për qëllime individuale jetësore investimi.*

<sup>14</sup> Shihni përgjigjen në pyetësorin e datës 11.10.2021.

<sup>15</sup> Shihni përgjigjen nr. 1 në pyetësorin e datës 15.10.2021.



*Ai ka vendosur ta derdhë këtë shumë, ndër të tjera, me qëllim që të respektohej detyrimi i bërë me dije nga ana ime nëpërmjet njohjes me faktin që sipas ligjit nr. 84/2016 dhe informacionit ndihmës që gjendet në faqen nr. 2 dhe 3 të shtojcës 2 të këtij ligji, depozitimi i shumave mbi 1.5 milionë lekë duhej të kryhej para datës së depozitimit të deklarimit të pasurisë. Depozitimi është kryer në përputhje me përcaktimet e ligjit, pesë ditë para depozitimit të deklaratës së pasurisë që është realizuar më 29.1.2017. Qëllimi udhëheqës i këtyre veprimeve dhe deklarimeve respektive ka qenë vetëm transparenca ndaj procesit të Vetting-ut, mbi veprimtarinë ekonomike timen dhe të familjarëve të mi, pa asnjë hezitim”.*

**31.5** ISSH-ja ka konfirmuar<sup>16</sup> se shtetasi E. F. është i punësuar pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. dhe për periudhën janar 2012 – 31.12.2016 ka përfituar pagë neto në shumën totale 3.070.121 (tre milionë e shtatëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e një) lekë.

**31.6** Nga verifikimi i llogarive bankare ka rezultuar se shtetasit E. F. i ka kaluar paga neto çdo muaj në llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank në periudhën shtator 2009 – dhjetor 2016, në shumën totale 4.602.671 (katër milionë e gjashtëqind e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë<sup>17</sup>. Nga lëvizja e llogarisë ka rezultuar se balancat në fund të çdo viti kanë qenë në vlera minimale, si dhe vihet re se paga është tërhequr vazhdimisht në çdo muaj.

**31.7** Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësitë e krijimit të kësaj depozite nga vëllai i subjektit, duke marrë në konsideratë në mënyrë potenciale të ardhurat nga paga<sup>18</sup> dhe shpenzimet përkatëse jetike, si dhe duke kryer një analizë kumulative për të gjithë periudhën (në mungesë të deklarimeve), nga e cila rezultoi se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka mundësi për krijimin e kësaj depozite me burime të ligjshme.

**31.8** Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me pasurinë depozitë të deklaruar nga personi i lidhur.

**32. Personi i lidhur E. F.**, vëllai i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 7.000 (shtatë mijë) euro. Burimi i krijimit: prej pagës dhe shërbimit nga \*\*\*, Tiranë, si dhe \*\*\*.

**32.1** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në ILDKPKI<sup>19</sup> si dokumentacion vërtetimin nga \*\*\*, ku për periudhën 2013 – 2016 ka përfituar në total shumën 2.769.892 (dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë (ekuivalent në shumën 20.477 euro), e cila përbëhet nga: pagë neto në shumën totale 2.103.218 (dy milionë e njëqind e tre mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) lekë për periudhën 2014 – 2016; pagesë për kontratë shërbimi për periudhën 2013 – 2016 në shumën neto 940 (nëntëqind e dyzet) USD dhe 1.949 (njëmijë e nëntëqind e dyzet e nëntë) euro; dieta për periudhën 2013 – 2016 për të cilat nuk është paguar tatimi në shumën 1.810 (njëmijë e tetëqind e dhjetë) euro dhe 308 (treqind e tetë) USD. Në vijim, subjekti ka depozituar vërtetim nga Fakulteti \*\*\* dhe *statement* nga BKT-ja për vlerën 36.143 (tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e tre) lekë, të përfituar nga Fakulteti i \*\*\* si pedagog i jashtëm për periudhën 2015 – 2016, si dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2017, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet së cilës konfirmohen pagat bruto dhe neto pranë \*\*\* për periudhën prill 2014 – tetor 2016.

**32.2** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësorin standard<sup>20</sup> se gjatë periudhës së qëndrimit në Tiranë ka bashkëjetuar me vëllain E. F., me shpenzime jetese të përbashkëta.

**32.3** ISSH-ja ka konfirmuar<sup>21</sup> se shtetasi E.F. i është i punësuar pranë \*\*\* sh.a. dhe për periudhën prill 2014 – maj 2016 ka përfituar pagë neto në shumën totale 1.747.502 (një milion e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e dy) lekë dhe në muajin tetor 2016 ka përfituar

<sup>16</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, seksioni \*\*\*.

<sup>17</sup> Ky shtetas ka përfituar shpërblim për vjetërsi pune në vlerën 324.000 lekë, e kaluar në llogarinë e pagës në qershor të vitit 2016, e cila konfirmohet në shkresën e ISSH-së si pagë neto për muajin maj.

<sup>18</sup> Për periudhën shtator 2009 – 2016 të ardhurat janë llogaritur nga lëvizja e llogarisë në Raiffeisen Bank.

<sup>19</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, seksioni \*\*\*.

<sup>20</sup> Shihni përgjigjen nr. 2 në pyetësorin standard.

<sup>21</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, seksioni \*\*\*.

pagë neto në vlerën 35.501 (tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e një) lekë nga subjekti Fakulteti i \*\*\*\*.

**32.4** Nga verifikimi i llogarive bankare ka rezultuar se shtetasi E. F. ka kryer veprime me çek në llogarinë bankare në euro të \*\*\* -Komisioni Evropian, në BKT, dhe ka tërhequr me çek çdo muaj pagën neto, duke përfituar shumën totale 20.613 (njëzet mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë) euro për periudhën prill 2014 – 2016. Nga verifikimi i llogarisë bankare në BKT rezulton se ai ka përfituar pagë nga Fakulteti i Drejtësisë në shumën 36.143 (tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e tre) lekë në shtator të vitit 2016.

**32.5** Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësitë e krijimit të shumës 7.000 (shtatë mijë) euro nga vëllai i subjektit, duke marrë në konsideratë në mënyrë potenciale të ardhurat nga paga për të cilat janë paguar detyrimet tatimore dhe shpenzimet përkatëse jetike/udhëtimi, si dhe duke kryer një analizë kumulative për të gjithë periudhën (në mungesë të deklarimeve), nga e cila rezultoi se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka mundësi financiare për krijimin e kësaj gjendjeje *cash* të deklaruar me burime të ligjshme.

**32.6** Komisioni ka hetuar për shtetasin E. F. në lidhje me pasuri të krijuara prej tij. Nga kërkimi në ASHK *online* dhe nga shkresat e dërguara për Komisionin nuk kanë rezultuar pasuri të paluajtshme në emër të këtij shtetasi.

**32.7** DPSHTRR-ja nuk ka konfirmuar për Komisionin pasuri të luajtshme në emër të vëllait të subjektit të rivlerësimit.

**32.8** Nga kërkimi në AMF nuk kanë rezultuar automjete në pronësi apo përdorim të këtij shtetasi deri në vitin 2019. Ky shtetas rezulton përdorues i automjetit tip “\*\*\*\*”, me targë \*\*\*, në pronësi të motrës së tij, znj. A. F., për periudhën 2020 – 2021 (kjo pasuri është detajuar në sektorin “Gjetje të tjera”).

**32.9** Zyra e regjistrimit noterial nuk ka konfirmuar për Komisionin lidhje kontratash noteriale për transaksione të ndryshme të kryera nga babai i subjektit.

**32.10** Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me pasurinë e deklaruar nga personi i lidhur, si dhe nuk kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme.

## **GJETJE TË TJERA**

**33. Automjet tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 2007, me targë \*\*\*, blerë nga personi i lidhur A. F., motra e subjektit të rivlerësimit, datë 17.8.2020.** Kjo pasuri ka rezultuar nga veprimet në regjistrin noterial e, më tej, nga verifikimi i dosjes së automjetit (pasuri e krijuar jashtë periudhës së rivlerësimit).

**33.1** DPSHTRR-ja, me anë të shkresës nr. \*\*\*\* prot., datë 14.9.2020, konfirmon për Komisionin se automjeti me targë \*\*\* është i regjistruar në emër të shtetasës A. F., duke përcjellë edhe dosjen e tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton se:

**33.2** Automjet tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 2007, me targë \*\*\*, rezulton se është blerë nga shtetasja D. T. sipas Kontratës së Shitjes datë 6.8.2020, në vlerën 1.000 (njëmijë) franga zvicerane nga shoqëria “\*\*\*\*”.

**33.3** Sipas deklaratës doganore, ky automjet është zhdoganuar më 9.8.2020 në Doganën Elbasan nga shtetasja D. T. dhe detyrimi doganor i paguar prej saj është në vlerën 33.431 (tridhjetë e tre mijë e katërqind e tridhjetë e një) lekë.

**33.4** Në bazë të kursit të këmbimit të monedhës franga zvicerane në lek të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020, vlera e blerjes së automjetit nga shtetasja D. T. ishte 115.070 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë) lekë, e cila së bashku me vlerën e zhdoganimit prej 33.431 (tridhjetë e tre mijë e katërqind e tridhjetë e një) lekësh, ka një kosto prej 148.501 (njëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind e një) lekë.

**33.5** Me Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.8.2020, ky automjet është blerë nga motra e subjektit të rivlerësimit në vlerën 5.500 (pesë mijë e pesëqind) euro, e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

**33.6** Komisioni nuk ka konstatuar problematika sa i përket pasurisë së krijuar nga personi i lidhur jashtë periudhës së rivlerësimit, si dhe nuk kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme.

#### **34. Analiza financiare për periudhën e rivlerësimit**

**34.1** Bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni u krye analiza paraprake e treguesve financiarë për periudhën 2.11.2010 – 2016.

**34.2** Nga analiza e përgjithshme financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mundësi të justifikojë me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurive të zotëruara prej saj dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera përgjatë periudhës së rivlerësimit.

**35. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë,** trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të saktë në përputhje me ligjin, ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe nuk gjendet në situatë konflikti interesi sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

**35.1** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

#### **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**36.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**37.** Në përfundim, AKSIK-ja ka dërguar në datën 31.10.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin Marsida Frashëri, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës, raport të cilin e ka deklasifikuar plotësisht.

**38.** Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së përditësim të informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit përderisa raporti pararendës kishte kryer verifikimet deri në datën 31.10.2017 dhe deklasifikim. AKSIK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2022, ka deklasifikuar raportin për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, dhe ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

**39.** Komisionit nuk i kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* të tjera për këtë subjekt rivlerësimi.

**40.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

#### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**41.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja; (b) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (c) denoncimet e paraqitura në Komision; (ç) dokumentacionin e mbledhur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

**42.** KLP-ja, si organi ndihmës për vlerësimin profesional të subjekteve, dërgoi raportin profesional për subjektin e rivlerësimit, bazuar në 3 dokumente ligjore, si dhe 5 dosje të përzgjedhura me short.

**42.1** Nga 8 dosje të analizuara është konstatuar se për dokumentin ligjor nr. 3 të paraqitur prej saj “Vendim për kryerjen e ekspertimit psikiatriko - ligjor”, Komisioni ka konstatuar se dokumenti i paraqitur nuk plotëson kriteret e parashikuara nga neni 3/2 i ligjit nr. 84/2016 dhe nuk mund t’i nënshtrohet rivlerësimit, pasi vendimi i marrë për kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjor është një vendim prej të cilit nuk mund të dallohen aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit sepse ai lidhet me një veprim hetimor pa afat në kuadër të një hetimi. Për dosjen nr. 2 të përzgjedhur me short, për procedimin penal nr. \*\*\* (vendosur pushimi i procedimit/akti – vendimi i pushimit) Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi profesionale sa i përket mungesës së aftësisë për të hetuar e marrë urdhra e vendime në kohën e duhur, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke regjistruar procedimin me vonesë dhe duke zvarritur hetimet për një periudhë njëvjeçare pa shkak, duke qenë se vepra penale për të cilën ishte regjistruar procedimi i nënshtrohej ligjit nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”.

### **43. Nga verifikimi i të dhënave arkivore ka rezultuar se:**

a) Në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka marrë një masë disiplinore “Kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të drejtësisë”, duke kryer detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për një periudhë 6-mujore. Arsyeja e marrjes së masës disiplinore ka qenë për shkak të konstatimit të mangësive profesionale në drejtim të mosefektivitetit në punë. Në përfundim të verifikimeve, Komisioni ka konstatuar shkelje të shumta dhe të ndryshme ligjore, ku në disa procedime penale të ndjekura prej saj është vënë re neglizhencë e pajustificuar në fazën e regjistrimit të procedimit penal, duke mos përmbushur detyrimet e parashikuara në nenin 287/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe të udhëzimit nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”. Gjithashtu, nuk janë kryer plotësisht dhe në vijueshmëri veprimet e domosdoshme hetimore paraprake, duke zvarritur në mënyrë të pajustificuar hetimet paraprake të procedimeve dhe duke treguar neglizhencë të pajustificuar për të marrë vendim përfundimtar.

b) Në vitin 2019, me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm është filluar një hetim tjetër disiplinor ndaj prokurores Marsida Frashëri, me objekt çeljen e zyrës së prokurores Marsida Frashëri dhe inventarizimin e akteve që ndodheshin në të, për shkak se prokurorja ishte caktuar përkohësisht në Prokurorinë e Përgjithshme si pjesë e grupit mbështetës për përgatitjen e vlerësimeve profesionale të prokurorëve, por nuk kishte kryer dorëzimin e materialeve që ndiqeshin prej saj. Pas çeljes së zyrës janë konstatuar kallëzime penale, procedime penale, akteksptime, përgjigje letërporosie dhe prova të ndryshme materiale që i përkisnin periudhës 2010 – 2017. Këto materiale nuk ishin dorëzuar, por janë mbajtur të mbyllura në zyrën e saj në rafta deri në momentin e konstatimit. Janë gjetur letërporosi dhe prova materiale. Nga verifikimi në regjistrin elektronik të kallëzimeve nuk u ishte dhënë zgjidhje ligjore. Megjithëse hetimi disiplinor është mbyllur për arsye se mungonte kuadri ligjor rregullues për të mundësuar identifikimin e shkeljeve që përbëjnë shkak për nisjen e procedurave disiplinore, në përfundim të verifikimeve për Komisionin ka rezultuar se veprimet e subjektit të rivlerësimit të vlerësuara në tërësinë e tyre, së bashku edhe me sjelljen e saj të vazhduar në institucionin ku ajo ushtronte detyrën si prokurore (Prokuroria e Rrethit Shkodër), tregojnë cilësi e aftësi të pamjaftueshme në punë e që cenojnë efektivitetin dhe eficiencën e institucionit në tërësi dhe të saj si prokurore në veçanti.

**44.** Sa i përket regjistrimit të ankesave pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se ndaj prokurores Marsida Frashëri ka pasur 6 praktika me ankesa nga disa shtetas. Në përgjithësi ka rezultuar mangësi profesionale në drejtim të zvarritjes së hetimeve dhe moskryerjes së

veprimeve hetimore në mënyrë të gjithanshme dhe shteruese në lidhje me objektin e veprimtarisë verifikuese.

**45.** Nga vlerësimi i denoncimeve të paraqitura në Komision, gjithsej 2, është pretenduar zvarritje hetimesh, moszbatim i afateve procedurale dhe mosushtrim me efikasitet i detyrës si prokurore. Komisioni ka vlerësuar si bindëse prapësimet e prokurores për denoncimin e parë, ndërsa denoncimi i dytë lidhej me çështjet e analizuara më herët të verifikuara nga Grupi i Punës i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

**46.** Në konkluzion të të gjithë vlerësimit profesional sa më sipër, të shtjelluar në mënyrë më të detajuar në vendimin e ndërmjetëm nr. 577 akti, nr. 6 vendimi, datë 13.5.2022, trupi gjykues konstatoi se subjekti ka shfaqur në mënyrë të përsëritur vonesa në trajtimin dhe përfundimin e çështjeve objekt shqyrtimi, në vazhdimësi gjatë ushtrimit të detyrës së saj si prokurore, duke krijuar rrethana me efekt negativ në rezultatet e vlerësimit profesional të saj. Komisioni vlerësoi në tërësi rezultatet e kontrolleve të ushtruara ndër vite dhe shkakun e tyre, si dhe vlerësimet e punës për subjektin, por pa e penalizuar për këto fakte në kuptim të parimit të gjësë së gjykuar, por duke i mbajtur në konsideratë ato, në vlerësim të dinamikës evolutive të performancës së subjektit në periudhën e mëpasshme, duke arritur në përfundimin se prokurorja Marsida Frashëri, në mënyrë të vazhduar, pavarësisht tërheqjes së vëmendjes apo marrjes së masës disiplinore, ka vijuar të ushtrojë funksionin në të njëjtën mënyrë, me mangësi në aspektin profesional. Mangësitë e konstatuara janë kryesisht ato të karakterit organizativ dhe veprimit me efikasitet, të cilat kanë sjellë në mënyrë të përsëritur mospërmbushjen e detyrës si prokurore, duke konkluduar se nuk është efektive.

**47.** Trupi gjykues i Komisionit u mbledh në dhomë këshillimi në datën 10.5.2022 dhe vlerësoi në tërësi problematikat e konstatuara, të cilat konsistonin në mangësi vazhduese ndër vite, por në një normë të pranueshme, që nuk mund të sillnin pasojën më radikale të shkarkimit nga detyra, duke konsideruar ngarkesën në total të punës së saj dhe çështjet e trajtuara prej saj gjatë ushtrimit të detyrës. Në vlerësim të këtyre fakteve dhe rrethanave, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ndodhej në kushtet e plotësimit të këtyre mangësive nëpërmjet një programi trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës.

**48.** Në vijim, me vendimin e ndërmjetëm nr. 577 akti, nr. 6 vendimi, datë 13.5.2022, u vendos pezullimi nga detyra i znj. Marsida Frashëri, për një periudhë njëvjeçare me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

**49.** Në përfundim të këtij trajnimit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2023, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar në Komision rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, bazuar në pikën 2 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016.

**50.** Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.7.2023, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, ka arritur rezultate të mira, duke tejkaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**51.** Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, duke çmuar se subjekti:

- ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;

- ka arritur një nivel të kënaqshëm kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale pas përfundimit me sukses të trajnimit njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës, duke mënjanuar mangësitë e konstatuara,

në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, nenit 59, pika 1 dhe të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 11.9.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Kryesues**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Genta Tafa (BUNGO)**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*